



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1

Përbërja

Me këtë Vendim, themelohet grupi punues për hartimin e Draft-Planit Komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2026-2028 në Komunën e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Shkëlzen Hajdini, Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kryesues
2. Zoran Stanojevic, Zyra Lokale për Komunitete, anëtar
3. Lulzim Qerimi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtar
4. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
5. Hyrije Qerkini, Qendra për punë sociale, anëtare

Neni 2

Detyrat e grupit punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin Draft-Planin Komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme në Komunën e Lipjanit 2026-2028 në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri me datën 10.03.2026.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyra Lokale për Komunitete, kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues.

1Nr. 020/04-7758

Lipjan, më 10.02.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljes e listes përfundimtare për OJQ-të (Klubet Sportive) për thirrje publike "Thirrje Publike për mbështetje Finacare për Aktivitete të Organizatave Joqeveritare në fushen e Sportit "Nr.05-453/01-40815 të datës 05.08.2025 , Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT ME NR1.453/01-55861/2 I DATËS 06.10.2025 PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - KLUBET SPORTIVE

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 40.000.00 (katerdhjet mijë euro) për subvencionimin e klubeve sportive të cilat kanë aplikuar sipas: "Thirrjes publike për mbështetje financiare për Aktivitete të Organizatave Joqeveritare në Fushën e Sportit "Nr.5-453/01-40815 të datës 05.08.2025, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-të-klubet sportive të cilat janë shpallur përfituese .

Nr.	Emërtimi i OJQ-së)	Shuma
1.	K.V "Skenderbeu"	15.000.00 €
2.	K.F" Arbëria"	10.000.00 €
3.	K.F "Gadimja"	10.000.00 €
4.	K.F "Ulpiana 1992"	5.000.00 €
	Shuma Totale	40.000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pagesat ndaj OJQ-ve për vitin 2025 nuk kanë mundur të realizohen për shkak të mungesës së mjeteve financiare buxhetore në kategorin përkatëse gjatë këtij viti fiskal dhe lidhur me këtë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Neni 3

1. Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese .

2.Kontrata do të lidhet vetëm me atë OJQ e cila para nënshkrimit të Kontratës ka paraqitur Prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara ashtu siq precizohet edhe në Thirrjen e cekur publike.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet vendimi me 1Nr.453/01-55861/2 i datës 06.10.2025

1Nr. 453/01-9641
Lipjan, më 24.02.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues Nr.05-453/01-6771 të datës 05.02.2026 për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-në përfituese “17 Shkurti -Dita e Pavarësisë së Kosovës 2026” “Thirrjes publike për mbështetje financiare për aktivitetet e “17 Shkurtit- Dita e Pavarësisë së Kosovës 2026” Nr.5-453/01-69421 të datës 24.12.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ –NË GOAL FOR THE TROPHY-
QËLLIMI PËR TROFE**

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 7.000.00 (shtatë mijë euro) për subvencionimin e organizates joqeveritare e cila ka aplikuar sipas: “Thirrje publike për mbështetje financiare në ” Nr.5-453/01-69421 të datës 24.12.2025”, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja- e cila është shpallur përfituese .

Nr.	Emërtimi i OJQ-së)	Shuma
1.	Goal for the Trophy- Qëllimi për Trofe	7.000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

1. Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese .
- 2.Kontrata do të lidhet vetëm me atë OJQ e cila para nënshkrimit të Kontratës ka paraqitur Prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara ashtu siq precizohet edhe në Thirrjen e cekur publike.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 453/01-6771/2
Lipjan, më 06.02.2026





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR
SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **12,320.00€**, (dymbdhjetmijë e treqind e njëzetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/04-5486 e datës 02.02.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 44 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin janar të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast $44 \times 280 = 12,320.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/04-5486
Lipjan, më 03.02.2026

KRYETARI I KOMUNËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "Për Implementimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunen e Lipjanit" Nr.01-453/01-469 të datës 06.01.2026, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Agnesa Trpeza nga OJQ-të anëtare
5. Majlinda Krasniqi, në cilësinë e ekspertes të jashtme, anëtare
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtarë rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike "Për Implementimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunen e Lipjanit" Nr.01-453/01-469 të datës 06.01.2026, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

→ INr. 020/04-7130
Lipjan, më 06.02.2026





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA: 20.02.2026			
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01 -	020/09	9248	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejojnë qendra mësimore të cilat mbështesin nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore nr.04-453/01-6476 të datës 04.02.2026, në përbërje si vijon:

1. Liridon Duhlaku, Drejtorati për Arsim, Kryesues
2. Teuta Berisha, Drejtorati për Arsim, anëtare
3. Albulena Govori Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Bekim Krasniqi nga OJQ-të anëtar
5. Feim Olluri, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtar
6. Floranda Zeqiri, Drejtorati për Arsim, anëtare rezervë

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejojnë qendra mësimore të cilat mbështesin nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe nxënës të tjerë që kontribuojnë në arritjen arsimore nr.04-453/01-6476 të datës 04.02.2026, të shpallur nga Drejtorati për Arsim. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 01-020/09-9248
Lipjan, më 20.02.26

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE TË
STUDENTËVE PËR NDARJEN E BURSIVE

Neni 1
Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të studentëve për ndarjen e bursave të cilët kanë aplikuar sipas Konkursit publik të shpalluar nga Drejtorati për Arsim me Nr.4-610/01-4218 i datës 27.01.2026, në përbërje si vijon:

1. Mexhide Gashi, Drejtorati për Arsim, Kryesues
2. Miranda Gashi, Drejtorati për Arsim, anëtare
3. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e studentëve për ndarjen e bursave brenda afatit 15 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit publik, konform kriterëve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15.Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 dhe kriterëve të përcaktuara në Konkursin publik të shpalluar nga Drejtorati për Arsim me Nr.4-610/01-4218 i datës 27.01.2026.
2. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni shpallë listën preliminare në faqen zyrtare të Komunës ndërsa pas përfundimit të procedurave të ankesave Komisioni vlerësues shpallë listën përfundimtare të përfituesve.
3. Punët administrative- teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Arsim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit me kopjen e të cilit do të njoftohen DKA-ja, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-5511

Lipjan, më 02.02.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 1

Me këtë Vendim, **Trimor Shamolli**, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve **Goal for the Trophy- Qëllimi për Trofe**, për Thirrjen publike Nr.5-453/01-69421 të datës 24.12.2025 (17 Shkurti –Dita e Pavarësisë së Kosovës 2026), të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve Goal for the Trophy- Qëllimi për Trofe, konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Trimor Shamolli dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-7859
Lipjan, më 11.02.2026



KRYETARI I KOMUNËS

Ilir Ahmeti